



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NJOFTIM PËR LIKUIDIM

NSH “Kri-Kos”

Emrat alternativë/emrat e mëparshëm dhe numrat e regjistrimit:

“Organizata Punuese “STAKLOPAN” Xhamprerëse me përgjegjësi të përgjithshme të pakufizuar,
Beograd, Fi.8742/89, 12.02.1990”

“Ndërmarrja Shoqërore “STAKLOPAN” me përgjegjësi të plotë, Fi.3793/90, 27.04.1990”

“Ndërmarrja Shoqërore “STAKLOPAN” Beograd, njësia “STAKLOPAN” Prishtinë, me lokacion në
Zonën Industriale në Prishtinë Fi.11304/91, 17.10.1991”

Në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-067 MBI AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT, neni 230 i Ligjit Nr. 02/L-123 MBI ORGANIZATAT E BIZNESIT, dhe neni 49 të Rregullorës së UNMIK-ut 2005/48, ME ANË TË KËSAJ NJOFTOHET se likuidimi i Ndërmarrjes së lartpërmendur ka filluar prej **08 Nëntor 2010**, në bazë të vendimit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit më **23/24 Shtator 2010** sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-067 MBI AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT.

Në përputhje me Kapitullin 6, Nenin 6.1 të Ligjit Nr. 03/L-067 MBI AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT dhe neni 43.3 (d) dhe (e) të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48, çdo person i cili beson se ai/ajo ka të drejtë kërkesë ndaj kësaj Ndërmarrjeje – qoftë si kreditor, apo në lidhje me çfarëdo lloj aseti që ka të bëjë me ndërmarrjen, apo si pronar i ndërmarrjes, si dhe çfarëdo kërkesë tjetër – **duhet të paraqesë Dëshminë e Kërkesës rreth Likuidimit deri më 18 Janar 2011**. Nëse nuk bëhet kjo, kjo mund të rezultojë që personat e tillë nuk do të kenë mundësi të marrin pjesë në ndarjen e fondeve të fituara nga likuidimi.

Formularët e Dëshmisë së Kërkesës rreth Likuidimit mund të merren dhe duhet të dorëzohen në ndonjërin prej këtyre zyrave të AKP-së:

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Zyra Rajonale e Prishtinës

Rr. Rexhep Mala Nr. 2,

10000 Prishtinë

Kosovë

Telefoni: +381 (0) 38 226 889

Fax: +381 (0) 38 227 100

Formularët për kërkesa gjithashtu mund të merren edhe nga faqja e internetit e AKP-së në adresën www.pak-ks.org. Për detaje se si të dorëzohet kërkesa, shih “Si të paraqitni një kërkesë.”

Lista e aseteve dhe lista e paraqitësve të kërkesave do të mbahet në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në **Agjencia Kosovare e Privatizimit, Zyra Rajonale e Prishtinës, Rr. Rexhep Mala Nr. 2, 10000 Prishtinë, Kosovë** do të jetë e hapur për shqyrtim publik në këtë zyrë pas **18 Janarit 2011** (ose ndonjë datë tjetër që do të shpallet publikisht), deri në njoftimin e ardhshëm. Nëse keni arsye legjitime për pamundësinë e udhëtimit deri në vendin e lartpërmendur, ju lutemi të kontaktoni në adresën e mësipërme për të aranzhuar mënyrë tjetër të qasjes.

Asetet do të ofrohen për shitje nëpërmes tenderit me oferta të mbyllura në datën (jo me herët se **01 Janar 2011** që do të shpallet në të njëjtën mënyrë si edhe kjo shpallje, duke përfshirë shpalljen edhe në faqet e internetit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. www.pak-ks.org.